

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II. ad Cor. III. 17).

1. Në prëhen të nânës trajtohen kombet	Fq. 1
2. Shinime estetike. — <i>Mbi natyrë t' Artit</i>	„ 8
3. Kush po na e shemton giûhen ?...	„ 13
4. Martesa e Plakut Qefanak. — <i>Rapsodí</i>	„ 19
5. Tuj kontrolue tre registra	„ 24
6. Tu Krojet e Bardha. — <i>Novelë historike</i>	„ 32
7. Nji udhtim në Turki të Ré	„ 45
8. Rreth „Hymnit të Flamurit“	„ 53
9. Biblioteka e „Hyllit“	„ 54
10. Quo Vadis...? — 13.	„ 97

SHKODER

Shtypshkroja Françeskane

1933.

POSTA E JONË

Pajtimtarve të vjetshem: E kemi detyrë me U u falë nderës të gjithëve për simpatí, që dëftuet ndaj të Perkohshmen t' onë rrokull vjetit të kaluem, tuj pasë shpresë të ngultë se edhe rrokull ktij vjeit të rí keni me dëftue një simpatí edhe më të madhe ndaj ket të Perkohshme, masi të dishmohna edhe na për herë e më fort të gatshem për me i çue në vend dishiret t' Ueja, si e dishmon shi ky numer më i pari i ktij vjetit.

Pajtimtarve të rí: U porositena me u mledhë sá më me shumicë rreth nesh për me na ndimue se i cilli mas asajë fuqís së vet, në naltsimin e nderesës s' onë letrare-shqyptare.

Të gjithëve po U dergojm *gratis* Kalendarin e vogel të „Hyllit“.

Bashkpuntorve t' onë: Fletët e „Hyllit“, rrín çilë për të gjith, mos u kurseni prandej me bashkpunue me né, masi na dishrojm të kemi bashkpuntorë prej degve e rretheve sá më të ndryshme për me mÿjtë kshfÿ me plotsue çdo nevojë të qarqeve intelektuale shqyptare.

TIRANË: Sh. M. U. — Mas porosis, që na bájshi po U dergojm shka lypshi: shka dishrojshi, mundni me e gjetë shi në ket numer, që po U çojm.

TIRANË: K. Ll. — Kemi marrë letren me gjithshka çojshi: për shka dishrojshi keni me mÿjtë me u marrë vesht gojarisht me Redaktorin t' onë.

KRUE: J. K. — U falemi nderës fort e fort për shka shkruiejshi, e na vjen keq që s' kemi mÿjtë me u kondendue më parë: nuk kemi diejtë gjá të sugurtë për drejtim t' Uej. Na falni edhe ke s' mÿjtem me u kondendue, mostjeter masi na shkruiejshi. Për áisht vendim i marrun që mos me mÿjtë me e kputë vjetin: sá për numra të veçantë mundni me shikue vrejten në mlojçë të

Hylli i Dritës

Në prëhen të nânës
trajtohen kombet.



apoleon Bonaparti, i pvetun nji ditë, si do të mund t' u reformote shteti i Francës, pergjegji: *Filloni te nanat, në prëhen të sajë trajtohen kombet.*

Fjalët e luftarit të madh kjene të verteta, pse nana kje ajo qi i dha prîsit të Francës djelmosha punet e sakrificit, djelmosha të pajuem me ndjesí vllaznore e me nji egoizem atdheje, djelmosha, të cillët nuk u tremben as para gjakut të sa njerzve, as para ushtrive të mbarë botës.

Faktori kryesuer edhe në kohët mâ të hershme, qi ve-proi mbí fmín kje nana. E eger per natyrë, pse e pa gdhe-nun, shtini në zemer të fmiyje dishirin per gjuetí e në të formoi shpirtin e luftarit e të grabitçarit, zemren e eger e të pa mëshrirë e e formoi kshtu, pse e tillë kje jeta n' ato kohë. Ma vonë, si njerzija filloi me hî në zdrukthin e kohës, edhe shpirti i njerzve ndryshoi. Mendimi me i mësue fmiijt me mendue vetun per vedi filloi me u hapë, tue u shndrrue pak ka pak në të menduemit edhe per tjerë, per familje, qytet të vet e ma vonë per nji atdhe të ngushtë; kshtu rrethi nisi me u zgjâ, ndjesít njerzore filluen me bâ hapin e parë e n' ato kohë, me gjith se nana gjindej endè larg kuptimit, qi ka sot fjala nanë, mbrriti me bâ djelm me ndjesí ma të zhvillueme.

dh/17-290

